



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2024:035226

Datë: 31.05.2024

Numri i dokumentit: 05762764

P.nr.20/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në çështjen penale kundër të pandehurit B.G nga Prishtina, për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP-II.nr.445/23 e datës 30.01.2024, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me datë 02.05.2024, në të cilin ishin të pranishëm Prokurorja e Shtetit Vyrtyte Gërvalla dhe i pandehuri B.G, më dt.30.05.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 31.05.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: B.G nga i ati F., e ëma M., e gjinisë B., i lindur më datë ... në Prishtinë, ku edhe jeton, me numër personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, punon si kuzhinier në lokal in e prindit, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, edhe më parë i gjykuar, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Më datën 16.03.2023, rreth orës 01:00 në Vushtrri, me dashje dhe ka poseduar narkotike, në atë mënyrë që deri sa ka qenë duke e drejtuar veturën “Skoda”, me targa ..., pasi që është ndalur nga policia, gjatë kontrollit sipërfaqësor të veturës dhe të pandehurit, në xhëpin e xhakëtës i është gjetur substancë narkotike të llojit kanabis (marihuanë) që përmban Tetrahidrokanabinol (THC), me peshë prej 1.38 0.0001 gram,

- Me këtë ka kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 46, 47, 48, 49, 69, 70 dhe nenit 269 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 241, 242, 276, 364 dhe 449 të KPPK-së, e

G J Y K O N

Të pandehurit: B.G i shqipton DËNIM ME BURG në kohëzgjatje pesë (5) muaj, me pëlqimin e të pandehurit e konform nenit 44, dënimin me burgim ia zëvendëson me DËNIM ME GJOBË në shumën prej njëmijë e pesëqind (1,500) euro, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit dhe DËNIM ME GJOBË në shumën prej njëmijë (1,000) euro, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Ne rast se i pandehuri refuzon të paguajë dënimet me gjobë, atëherë dënimet me gjobë do të shndërrohen në dënim me burg, duke i caktuar të akuzuarit për çdo njëzetë (20) euro të dënimit me gjobë, nga një (1) ditë burgim.

URDHËROHET konfiskimi i përhershëm nga Policia e Kosovës i substancës narkotike i llojit kanabis – marihuanë që përmban Tetrahidrokanabinol (THC) me peshë neto 1.38 0.0001 gram.

DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20€), si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej njëqind euro (100€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP-II.nr.445/23 e datës 30.01.2024, kundër të pandehurit B.G nga Prishtina, për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së,

Deklarimi i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë

Në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur më dt.30.05.2024, ku pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, në kuptim të nenit 241 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues pasi bindet se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ofron mundësinë e deklaramit rreth fajësisë, ashtu që:

I pandehuri B.G ka deklaruar se e pranon fajësinë, është penduar thellë për kryerjen e veprës penale, duke i premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra të kësaj natyre apo natyrës tjetër. Njëherit e ka informuar gjykatën që prej 1 viti nuk e përdori për shkak se jam me dënim të kushtëzuar dhe e kam parë që jam duke bërë gabim.

Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë

Prokurorja e shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, për veprën penale nga neni 269 par.1 të KPRK-së, pasi që ky deklarim është në përputhje me të gjitha faktet dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës, e që vërtetojnë gjendjen faktike si në dispozitiv të aktakuzës. Në rast se gjykata e aprovon pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, me rastin e matjes dhe përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, të marrë si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë, premtimin e tij se nuk do të përsërisë më këtë veprë penale, ndërsa si rrethanë rënduese të ketë parasysh rrezikshmërinë shoqërore që paraqet kjo veprë penale. Po ashtu mbesim pranë propozimit si në pikën III të aktakuzës lidhur me konfiskimin e substancës narkotike.

Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë

Në shqyrtimin fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i njëjti, se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën, si: Raporti fillestar i incidentit i datës 16.03.2023, Raportet e oficerit të datës 16.03.2023 dhe raportin policor i datës 16.03.2023, Procesverbali i marrjes në pyetje në polici i të pandehurit B.G i datës 16.03.2023, të dhënë në hetuesi, Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i datës 16.03.2023, Raportin e ekspertimit AKF/2023-3486/23-3319 të datës 16.01.2024, informacionet personale si dhe shkresat tjera përcjellëse të lëndës.

Gjendja faktike e vërtetuar

Bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se i pandehuri nga me dashje ka kryer veprën penale Posedim i paautorizuar i substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK -së në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në nenin 269, par.1 të KPRK-së është përcaktuar se formën themelore të veprës penale e kryen “Kushdo që pa autorizim posedon narkotikë, substanca psikotrope apo analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet.”.

Andaj, bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpall fajtor për kryerjen e veprës penale Kanosja nga neni 269 par.1 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtat është edhe penalisht përgjegjës.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, bazuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Si rrethanë lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, premtimin e të njëjtit se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra penale, pendimin e tij për kryerjen e veprës penale si dhe faktin që më nuk është konsumues i substancave narkotike, ndërsa si rrethana

rënduese sa i përket të pandehurit gjykata ka gjetur intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur, shkallën e përgjegjësisë penale si dhe faktin që edhe më parë ka qenë i gjykuar dhe atë aktgjykimet P.nr.1952/2019, P.nr.1036/2020, P.nr.4343/2017, P.nr.1620/2019, P.nr.304/2023 dhe P.nr.3470/2021.

Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të njëjtit nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Arsyet lidhur me konfiskimin e substancave narkotike, shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit

Vendimin lidhur me konfiskimin e substancave narkotike gjykata e ka marrë në bazë të nenit 269 par.3 e lidhur me nenin 276 par.2 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 nën par. 2.6 të KPPK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.5 dhe nenin 39 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.20/2024, datë 31.05.2024

GJYQTARI
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.